



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
DREJTORIA EKONOMIKE  
SEKTORI SHËRBIMIT SOCIAL

Nr. 8076 prot

Roskovec, më 14.12.2023

PROJEKT-VENDIM

Nr. 104 datë 14/12/2023

**PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR  
DERI 6% PËR PERIUDHËN 1-31 NËNTOR 2023**

Në mbështetje të nenit 21 të Ligjit nr. 57/2019, "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë", në pikën 2, 3, 6, 9, dhe 10 të Kreut IV të Vendimit nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", Vendimit të Këshillit të Bashkisë nr.3, date 27.01.2023, "Për miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike, nga fondi i kushtëzuar deri 6% për bllok-ndihmën për vitin 2023", administratorët e seksionit të ndihmës sociale i propozojmë Këshillit të Bashkisë Roskovec gjatë muajit Nëntor 2023, për sa më poshtë:

Përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri 6% për muajin Nëntor 2023, në total 17 (shtatëmbëdhjet) familje me fond total prej 87392(Tetëdhjet e shtatë mijë e treqind e nëntëdhjet e dy ) lekë. Konkretisht:

**PËR BANORËT E QENDRËS SË BASHKISË ROSKOVEC**

Përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri 6% për muajin Nëntor 2023, 5(pesë) familje me një fond 14351(katërmëdhjet mijë e treqind e pesëdhjet e një ) lekë.

**PËR BANORËT E NJESISË ADMINISTRATIVE STRUM**

Përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri 6% për muajin Nëntor 2023, 1(një) familje me një fond 2178(dymijë e njëqind e shtatëdhjetë e tetë ) lekë.

## PËR BANORËT E NJËSISË ADMINISTRATIVE KUMAN

Përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri 6% për muajin Nëntor 2023, **6(shtatë)** familje me një fond **40254(dyzet mijë e dyqind e pesëdhjete katër)** lekë.

## PËR BANORËT E NJËSISË ADMINISTRATIVE KURJAN

Përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri 6% për muajin Nëntor 2023, **5(pesë)** familje me një fond **30609(tridhjet mijë e gjashtëqind e nëntë)** lekë.

Pas miratimit nga Këshilli i Bashkisë Roskovec, ngarkohet sektori i Financës dhe sektori i Shërbimit Social për ekzekutimin e këtij vendimi.

Konceptoi. *S.Saliaj*

Miratoi. *S.Çepele*

Konfirmoi. *D.Hoxha*

Për Drejtorinë e Burimve Njerëzore dhe Çështjeve Juridike . *V.Zeqo*



**Bashkia Roskovec**

Nentor 2023

FAMILJET QË DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR DERI NË 6%.

Nr	Emer Atesit Mbiemer	Nr. dosje	Nr. Frymeve	Lloji i ndihmës	Shuma
1	Agron Osmën Çanta		1	Familje në nevojë	2178
2	Bukuroshe Sali Çepele		1	Familje në nevojë	3146
3	Selvi Rystem Çepele		1	Familje në nevojë	3146
4	Zhaneta Ferrik Hatillari		2	Familje në nevojë	3703
5	Mehmet Hoxha		1	Familje në nevojë	2178
	<b>Shuma</b>				<b>14351</b>

Mbyllet me nr rendor 5(pesë)

**Sp.Z.Ndihmës Ekonomike**  
**Sonila Rrapushi**



**KRYETAR**  
**Majlinda Bufi**


Njesia Administrative Strum  
Nentor 2023

FAMILJET QË DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR DERI NË 6%.

Nr	Emer Ateshi Mbiemer	Nr.dosjes	Nr.Frymeve	Lloji i ndihmës ndihmes	Shuma
1	Drita Mehmet Cepele		1	Familje në nevojë	2178
	<b>SHUMA</b>				<b>2178</b>

Mbyllet me numrin rendor 1(nje)

Sp.Z.Ndihmes Ekonomike  
Romelda Cjapi



KRYETAR  
Majinda Buqi

Njësia Administrative Kuman

Nëntor 2023

FAMILJET QË DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR DERI NË 6%.

Nr	Emer Atesi Mbiemer	Nr.dosjes	Nr.Frymeve	Lloji i ndihmës ndihmes	Shuma
1	Alketa Flamur Lamo		5	Familje në nevojë	11880
2	Katolina Mevlud Shurdha		3	Familje në nevojë	8712
3	Klaudja Viktor Metaj		2	Familje në nevojë	5940
4	Sefret Tofik Hoxha		2	Familje në nevojë	3703
5	Aishe Jonus Akulli		1	Familje në nevojë	2178
6	Medar Sali Pelo		5	Familje në nevojë	7841
<b>6</b>	<b>Shuma</b>		<b>18</b>		<b>40254</b>


P/Shërbimit Social

Sidorela Saliqaj



KRYETAR

Majlinda BUFI



Njësia Administrative Kurjan


Nëntor 2023

FAMILJET QË DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR DERI NË 6%.

Nr	Emer Ateshi Mbiemer	Nr.dosjes	Nr.Frymeve	Lloji i ndihmës	Shuma
1	Yzedin Shaban Panahori		2	Familje në nevojë	3703
2	Agim Mino Zeka		5	Familje në nevojë	14652
3	Ramadan Gani Koronaj		1	Familje në nevojë	5720
4	Donika Hysni Lika		1	Familje në nevojë	2178
5	Kamber Riza Lamaj		3	Familje në nevojë	4356
	<b>Shuma</b>				<b>30609</b>

Mbyllet me nr rendor 5 (pesë)

P.Z.Ndihmës Ekonomike  
Erida Toro





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
DREJTORIA EKONOMIKE  
SEKTORI SHËRBIMIT SOCIAL

Nr. 8026/1 prot

Roskovec , më 14.12 .2023

Relacion: Për miratimin e familjeve në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike, nga fondi i kushtëzuar deri 6% për muajin Nëntor 2023

**KËSHILLIT TË BASHKISË**

**Roskovec**

***Të nderuar Këshilltarë!***

Në mbështetje të nenit 21 të Ligjit nr. 57/2019, “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, në pikën 2, 3, 6, 9, dhe 10 të Kreut IV të Vendimit nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, Vendimit të Këshillit të Bashkisë nr.3, datë 27.01.2023, “Për miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike, nga fondi i kushtëzuar deri 6% për bllok-ndihmën për vitin 2023”.

Sektori i ndihmës ekonomike ju paraqet për diskutim dhe miratim Projekt-Vendimin “Për miratimin e familjeve në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike, nga fondi i kushtëzuar deri 6% për muajin Nëntor 2023” Në këtë muaj janë përzgjedhur për tu trajtuar 17(shtatëmbëdhjet ) familje me fond 87392(tetëdhjet e shtatë mijë e treqind e nëntëdhjete dy) lekë, konkretisht 5 (pesë) familje në Njësinë Roskovec, 1(një) familje në Njësinë Administrative Strum, 6 (gjashtë) familje në Njesinë Administrative Kuman dhe 5 (pesë) familje në Njesinë Administrative Kurjan. Listat emërore të familjeve dhe fondin që merr çdo familje i gjeni bashkëngjitur Projekt-Vendimit të muajit Nëntor 2023.

Këto familje janë përzgjedhur duke u bazuar në nenin 21 të Ligjit nr. 57/2019, “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, në pikën 2, 3, 6, 9, dhe 10 të Kreut IV të

Vendimit nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” dhe në kriteret e miratuara nga këshilli i Bashkisë Roskovec në Vendimin nr.3, datë 27.01.2023,”Për miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike, nga fondi i kushtëzuar deri 6% për bllok-ndihmën për vitin 2023”.

Konceptoi: *S. Saliq*

Miratoi: *S. Çepele*

**KRYETAR**

**Majlinda BUFI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 8027 Prot.

Roskovec, më 14.12 2023

PROJEKT-VENDIM

Nr. 105 datë 14/12 /2023

PËR

MIRATIMIN E PLANIT VJETOR TË AKTIVITETEVE, TË PUNËS DHE TË  
KONSULTIMEVE PUBLIKE TË KËSHILLIT TË BASHKISË ROSKOVEC PËR  
VITIN 2024

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”, nenet 7,51,54, VKB  
Nr.19 datë 27.03.2020“Për miratimin e Rregullores së funksionimit të Këshillit të Bashkisë  
Roskovec” neni 120 pika 8,ju paraqesim,

Për diskutim dhe miratim:

1. Planin vjetor të aktiviteteve, të punës dhe të konsultimeve publike të Këshillit të  
Bashkisë Roskovec për vitin 2024 sipas tabelave bashkëngjitur këtij projekt-vendimi.
2. Pas miratimit të këtij projekt-vendimi në Këshillin e Bashkisë ngarkohen strukturat e  
Këshillit Bashkiak me zbatimin e tij.

Konc.Sek.Këshillit  
Arlinda Hajdini

KRYETAR

Afrim Plaka



## Këshilli Bashkiak Roskovec

Muaji	Përshkrimi i Aktivitetit për vitin 2024
<b>Janar</b>	<p>Mbledhje e Këshillit (<b>Plenare</b>)</p> <p>Mbledhjet e Komisioneve të Përhershme të Këshillit Bashkiak</p> <p>Pjesëmarrje në konferenca e aktivitete të ngjashme</p>
<b>Shkurt</b>	<p><b>Mbledhje e Këshillit (Plenare)</b></p> <p>Mbledhjet e Komisioneve të Përhershme të Këshillit Bashkiak</p> <p>Konsultime me komunitetin për çështje për të cilat ligji kane nevojë për konsultim shitje, blerje e dhenje me qera, norma e standarde të shërbimeve publike dhe funksioneve të tjera ligjore (nr. 1 gjithsej i konsultimeve: nr. 1 i Tema diskutimi për ndryshimet e Klimes.</p> <p>Plani vjetor i komunikimit dhe konsultimit me publikun</p> <p>Pjesëmarrje në konferenca e aktivitete të ngjashme</p>
<b>Mars</b>	<p>Mbledhje e Këshillit (<b>Plenare</b>)</p> <p>Mbledhjet e Komisioneve të Përhershme të Këshillit Bashkiak</p> <p>Hartimi i raportit të veprimtarisë vjetore të Këshillit</p> <p>Hartimi dhe prezantimi i raportit vjetor për transparencën në procesin e vendimmarrjes së Këshillit (ligji 146/2014, neni 20)</p>
<b>Prill</b>	<p>Mbledhje e Këshillit (<b>Plenare</b>)</p> <p>Mbledhjet e Komisioneve të Përhershme të Këshillit Bashkiak</p> <p>Konsultime me komunitetin për çështje të Draft PBA, ndryshim buxheti, norma e standarde të shërbimeve publike dhe funksioneve të tjera ligjore. (nr. 3 gjithsej: 3 ne NjA)</p>
<b>Maj</b>	<p>Mbledhje e Këshillit (<b>Plenare</b>)</p> <p>Mbledhjet e Komisioneve të Përhershme të Këshillit Bashkiak</p> <p>Ceremoni dhënie titull nderi</p>
<b>Qershor</b>	<p>Mbledhje e Këshillit (<b>Plenare</b>)</p> <p>Mbledhjet e Komisioneve të Përhershme të Këshillit Bashkiak</p> <p>Ceremoni dhënie titull nderi</p>

<b>Korrik</b>	Mbledhje e Këshillit - <b>(Plenare)</b>
	Mbledhjet e Komisioneve të Përhershme të Këshillit Bashkiak
	Shqyrtim i dokumenteve të Administratës
	Emission në median vendore dhe online
	Përfaqësim institucional i Këshillit: (ne Shoqatat perkatese)
	Rishikim i Buxhetit vjetor
	Mbledhje e Këshillit <b>(Plenare)</b>
	Mbledhjet e Komisioneve të Përhershme të Këshillit Bashkiak
	Konsultime me komunitetin për çështjen e: shitje, blerje e dhënie me qera, norma e standarte të shërbimeve pubike dhe funksioneve të tjera ligjore, (nr. 1 gjithsej i konsultimeve: nr. 1 i konsultimeve me grupe interesi)
	Ndertimet e Sekretariateve
<b>Gusht</b>	Diskutime për Njësitë e Performancës dhe Zyra e Zhvillimit Ekonomik Lokal
	Mbledhje e Këshillit <b>(Plenare)</b>
	Mbledhjet e Komisioneve të Përhershme të Këshillit Bashkiak
	Konsultime me komunitetin për çështjen e: shitje, blerje e dhënie me qera, norma e standarte të shërbimeve pubike dhe funksioneve të tjera ligjore, Strategji e Plane (nr. 3 gjithsej i konsultimeve: nr. 2 i konsultimeve me NjA, nr.1 i konsultimeve me grupe interesi)
	Trainime të Këshilltarëve me fond të keshillit (në bashkëpunim me projektin Draftimi i planit vjetor i vendimarrjes së Këshillit (ligji 146/2014, neni 16/b)
	Draftimi i planit të trainimit për këshilltarët
	Hartimi i buxhetit të Këshillit Bashkiak për vitin
	Mbledhje e Këshillit <b>(Plenare)</b>
	Mbledhjet e Komisioneve të Përhershme të Këshillit Bashkiak
	Konsultime me komunitetin për çështjen e: buxheti apo ndryshim buxheti, pakete fiskale apo ndryshim, (nr. 3 gjithsej i konsultimeve: nr. 3 i konsultimeve me NjA)
<b>Tetor</b>	Ceremoni dhenje titull nderi
	Pjesëmarrje ne konferenca e aktivitetete të ngjashme
	Pritje e delegacionit nga keshilla homologe
	Vizite studimore ne Shqiperi
	Përfaqësim institucional i Këshillit në Shoqata, Këshill Konsultativ, etj.
	Diskutime për rolin e keshillit bashkiak ne institucionet e perfaqesimit

<b>Nëntor</b>	Mbledhje e Këshillit <b>(Plenare)</b>
	Mbledhjet e Komisioneve të Përhershme të Këshillit Bashkiak
	Konsultime me komunitetin për ceshitjen e: buxheti apo ndryshim buxheti, pakete fiskale apo ndryshim, (nr. 3 gjithsej i konsultimeve: nr. 2 i konsultimeve në NJA, nr.1 i konsultimeve me grupe interesi)
	Konsultime me komunitetin për ceshitjen e: shitje, blerje e dhenje me qera, norma e standarte të shërbimeve publike dhe funksioneve të tjera ligjore, Strategji e Plane (nr. 1 gjithsej i konsultimeve: nr.1 i konsultimeve me grupe interesi)
	Ceremoni dhenie titull nderi
	Pjesëmarrje në konferenca e aktivitete të ngjashme
	Mbledhje e Këshillit <b>(Plenare)</b>
	Mbledhjet e Komisioneve të Përhershme të Këshillit Bashkiak
	Pjesëmarrje në konferenca e aktivitete të ngjashme
	Një aktivitet me Rininë në kuadër të komisioneve rinore të ndërtuara. Emission në median vendore dhe online

**Dhjetor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Roskovec, më \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_, 2023

Lënda : **PLANI I KONSULTIMEVE TË KËSHILLIT BASHKIAK ROSKOVEC  
JANAR-DHJETOR 2024**

**Muaji Janar, Shkurt, Mars, Prill, Qershor, Korrik, Gusht, Shtator, Dhjetor**

Konsultime me komunitetin, sipas kërkesave që do të dalin rast pas rasti.

**Muaji Maj**

Konsultime me komunitetin për çështje të Draft PBA 2025-2027.

(në bashki qendër, në NjA, me grupe interesi dhe qytetare sipas kalendarit të konsultimeve).

**Muaji Tetor**

Konsultime me komunitetin për çështjen e: draft Buxheti, PBA 2025-2027, draft Paketa Fiskale (në bashki qendër, në NjA, me grupe interesi, grupe biznesi, OJF dhe qytetarë sipas kalendarit të konsultimeve).

**Muaji Nëntor**

Konsultime me komunitetin për çështjen e: Buxhetit dhe Paketës Fiskale (në bashki qendër, në NjA, me grupe interesi, grupe biznesi, OJF dhe qytetarë sipas kalendarit të konsultimeve).

- *Plani i konsultimeve mund të ndryshojë sipas nevojave të paparashikueshme në momentin e hartimit të tij.*

Konc.Sek.Këshillit  
Arlinda Hajdini

**KRYETAR**  
**Afrim Plaka**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
DREJTORIA E ARSIMIT DHE SHËNDETËSISË

Nr. 8028 Prot.

Roskovec, më 14, 12 2023

PROJEKT- VENDIM

NR. 106 DATË 14, 12, 2023

PËR

**MIRATIMIN E BURSIVE TË SHITETIT PËR NXËNËSIT E ARSIMIT  
PARAUNIVERSITAR NË INSTITUCIONET ARSIMORE PUBLIKE PËR VITIN  
SHKOLLOR 2023-2024.**

*Në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015 "Për Vetqeverisjen Vendore", i ndryshuar, të V.K. M-së Nr.666 datë 10.10.2019 "Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte, dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave dhe të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në Institucionet Arsimore Publike", i ndryshuar, të shkresës Nr.128 datë 01.11.2023 nga Shkolla e Mesme Bujqësore "Rakip Kryeziu" Fier, shkresës Nr.721, date 05.12.2023 së shkollës së Mesme Profesionale "Petro Sota", si dhe shkresës Nr.19749 datë 30.10.2023 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, ju paraqesim;*

**Për diskutim dhe miratim:**

❖ **Propozimin për miratimin e Bursave për nxënësit e arsimit parauniversitar (vitet e para), për vitin shkollor 2023-2024, si më poshtë:**

- 1. Laura Bahir Pire** – Bursë e Plotë, nxënës në Shkollën e Mesme Bujqësore "Rakip Kryeziu" Fier, drejtimi mësimor Shërbime Sociale dhe Shëndetësore.
- 2. Marjola Agim Zeka** – Bursë e Plotë, nxënës në Shkollën e Mesme Bujqësore "Rakip Kryeziu" Fier, drejtimi mësimor Shërbime Sociale dhe Shëndetësore.
- 3. Florjana Nasi Goga** - Bursë e Plotë, nxënës në Shkollën e Mesme Bujqësore "Rakip Kryeziu" Fier, drejtimi mësimor Shërbime Sociale dhe Shëndetësore.

4. **Ersi Aleksandër Profka**- Bursë e Plotë,nxënës në Shkollën e Mesme Bujqësore “Rakip Kryeziu” Fier, drejtimi mësimor Shërbime Sociale dhe Shëndetësore.
5. **Novrus Nori Toska** -Bursë e Plotë,nxënës në Shkollën e Mesme Profesionale “Petro Sota” Fier,drejtimi mësimor Termo Hidraulik.
6. **Kejson Afrim Hoxha** -Bursë e Plotë,nxënës në Shkollën e Mesme Profesionale “Petro Sota” Fier,drejtimi mësimor Shërbimi Mjeteve të Transportit.
7. **Klement Besnik Alla** - Bursë e Plotë,nxënës në Shkollën e Mesme Profesionale “Petro Sota” Fier,drejtimi mësimor Shërbimi Mjeteve të Transportit.
8. **Marjola Ilir Zeka** - Bursë e Plotë,nxënës në Shkollën e Mesme Profesionale “Petro Sota” Fier, drejtimi mësimor T.I.K .
9. **Thoma Nevin Thanasi** - Bursë e Plotë,nxënës në Shkollën e Mesme Profesionale “Petro Sota” Fier,drejtimi mësimor Termo Hidraulik.

- Bashkëngjitur këtij projekt-vendimi tabela e nxënësve aplikues sipas kriterëve përkatëse.
- Në rast të miratimit të këtij projekt-vendimi nga Këshilli i Bashkisë,ngarkohet Drejtorja e Arsimit dhe Shëndetësisë me zbatimin e tij.

**Konceptoi:** *E. Baxhia*

**Konfirmoi:** *M. Goga*

**KRYETAR**

**Majlinda Bufi**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
SEKTORI I QENDRAVE SOCIAL-KOMUNITARE

8029  
Nr. \_\_\_prot

Roskovec 14.12.2023

PROJEKT-VENDIM

NR 107 DATË 14.12.2023

**“PËR MIRATIMIN E PLANIT SOCIAL BASHKIA ROSKOVEC, 2024-2026”**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjes Vendore” i ndryshuar neni 24 dhe neni 54 gërma k, Ligjit Nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, ligjt nr 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit Nr.93/2014 “Për përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara”, Ligj Nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”. Ligji 22/2018 “Për strehimin social”, Ligji 47/2018 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” dhe VKM nr 518, datë 4.9.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar dhe rezidencial, kriteret, procedurat dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimeve të organizuar”

**Ju paraqesim për diskutim dhe miratim:**

1. Draftin e Planit Social, Bashkia Roskovec, 2024-2026 (sipas dokumentit bashkëngjitur)
2. Ngarkohet Drejtoria Ekonomike, Drejtoria Juridike dhe e Burimeve Njerëzore, Sektori i Qendrave Social-Komunitare, Sektori i Shërbimit Social për zbatimin e këtij vendimi.

Konceptoi: *N.Pelivani*

*S. Saliq*

Miratoi: *S.Cepele*

Konfirmoi: *D.Hoxha*

Për Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Cështjeve Juridike: *V.Zeqo*

**KRYETAR**

**Majlinda Bufi**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. 8030 prot.

Roskovec, më 14.12.2023

**PROJEKT- VENDIM**

Nr. 108, datë 14.12.2023

**PËR**

**MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË BASHKISË ROSKOVEC  
DHE TË NDËRMARRJEVE VARTËSE, PËR VITIN 2024**

Në mbështetje të nenit 54 shkronja “ç” të Ligjit 139/2015 datë 19.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar; VKM-së Nr. 328, datë 31.5.2023 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civil e të punonjësve administrativë të njësisë së vetëqeverisjes vendore”; VKM-së Nr. 325, datë 31.5.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”; VKM-së Nr. 326, datë 31.5.2023 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”; VKM-së Nr. 350, datë 19.4.2017 “Për trajtimin me pagë dhe shtesë mbi pagë të punonjësve të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi” të ndryshuar së fundi me VKM Nr. 240, datë 20.04.2023; VKM-së Nr. 175, datë 8.3.2017 “Për trajtimin me pagë dhe shtesë mbi pagë të punonjëve mësimorë dhe të tjerë jo mësimorë në arsimin parauniversitar”, të ndryshua së fundi me VKM Nr. 241, datë 20.04.2023; VKM-së Nr. 113, datë 01.03.2023 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”,

**JU PARAQESIM PËR DISKUTIM E MIRATIM:**

1. Miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë Roskovec për vitin 2024, sipas lidhjes nr. 1 bashkëlidhur.
2. Miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Ndërmarrjes së Mirëmbajtjes së Mjedisit (Pastrim, Gjelbërim dhe Kompostim të Mbetjeve Bimore) për vitin 2024, sipas lidhjes nr. 2 bashkëlidhur.
3. Miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Ndërmarrjes së Shërbimeve Komunale për vitin 2024, sipas lidhjes nr. 3 bashkëlidhur.

4. Miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Ndërmarrjes së Pyjeve, Ujitjes e Kullimit dhe Mirëmbajtje Rruge e Varreza për vitin 2024, sipas lidhjes nr. 4 bashkëlidhur.
5. Miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Qendrës Ekonomike Arsimore për vitin 2024, sipas lidhjes nr. 5 bashkëlidhur.
6. Efektet financiare në paga dhe sigurime shoqërore do të përballohen nga fondi përkatës në buxhetin e vitit 2024.
7. Ky vendim i shtrin efektet financiare nga data 01.01.2024.
8. Në rast miratimi, për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Ekonomike e Bashkisë Roskovec, si dhe Sektorët e Financës të katër ndërmarrjeve vartëse.

**Sekretari i Përgjithshëm**

Delina Hoxha



**KRYETARI**

**Majlinda Bufi**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
DREJTORIA EKONOMIKE

PROJEKT-VENDIM

Nr. 109, date 14 / 12 /2023

"PER MIRATIMIN E BUXHETIT, NUMRIT MAKSIMAL TE PUNONJESVE TE BASHKISE DHE  
NDERMARJET VARTESE TE BASHKISE PER VITIN 2024"

Ne mbeshtetje te ligjit 139/2015 "Per veteqeverisjen vendore", neni 54 pika ç dhe dh , te ligjit 68/2017 "Per financat e veteqeverisjen vendore", nenet 40 dhe 41 te tij , te ligjit nr. 9936 dt. 26.06.2008 "Per Menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne Republiken e Shqiperise" neni 6, 32, i ndryshuar, Udhezimi nr.9 date 20.03.2018 "Per procedurat standarte te zbatimit te buxhetit", si dhe materjaleve te paraqitura nga administrata e Bashkise;

-Ju paraqesim për diskutim e miratim,

I. Të miratojë planin e te ardhurave per vitin 2024 si me poshte vijon:

Te ardhura gjithsej : 603,412,171 leke

- |  |                  |
|--|------------------|
| • Te ardhura nga taksat dhe tarifate vendore                             | 295,391,369 leke |
| • Te ardhura nga taksat e ndara  | 76,100,000 leke  |
| • Te ardhura nga transfertat e pakushtezuara e pergjithshme(granti 2024) | 148,096,261 leke |
| • Te ardhura nga transfertat e pakushtezuar sektoriale 2024              | 83,824,541 leke  |
- II. Plani i shpenzimeve te Bashkise Roskovec per vitin 2024 eshte ne shumen 603,412,171 leke e detajuar si me poshte:
- |                      |                  |
|----------------------|------------------|
| • Shpenzime korente  | 376,035,031 leke |
| • Shpenzime kapitale | 227,377,140 leke |

**Nga te cilat:**

✓ Per pagat (600)	251,554,983	leke
✓ Per sigurimet shoqerore (601)	41,076,349	leke
✓ Per shpenzime operative&mirembajtje(602)	71,283,699	leke
✓ Per transferta (604-609)	12,120,000	leke
- Per emergjencat civile nga te ardhurat	1,500,000	
- Per fondin rezerve+kontigjenca	1,500,000	
- Kontribut K.Qarkut	300,000	
- Kontribut per Shoqaten e Bashkive	300,000	
- Ndihma ekonomike per nerezit ne nevoje	300,000	
- Bashkefinancim Projekte me donatore	6,800,000	
- Finacim I OSHC-ve ne kuader te projektit		
RELOAD	1,000,000	
- Kuote anetaresimi MED Cities	120,000	
- Kuote anetaresimi ne kuader te projektit "Mareveshje per klimen dhe energjine ne Ballkanin Perendimor dhe Turqin"	300,000	

✓ Shpenzime per investime ( Llog.230-231 – investime ne vazhdim dhe te reja) 227,377,140 leke

III. Te miratoje detajimin e buxhetit te te ardhurave dhe shpenzimeve te Bashkise Roskovec per vitin 2023 sipas pasqyrave nr.1 , nr.1/1 ,1/2 , pasqyrave nr.2, pasqyra nr.3,pasqyra nr.4, pasqyra nr.5 , pasqyra nr.6 pjese perberese te ketij vendimi.

IV. Te miratoj shperblimin e anetaresive te keshillit bashkiak dhe kryetareve te fshatrave ne masen 10% te pages se Kryetarit te bashkise.

V. Te miratoj rritjen e limitit te te ardhurave te bashkise Roskovec per vitin 2024 per diferencen e paperdorur te te ardhura dhe shpenzime per vitin 2023 pas rakordimit perkates perfundimtare me degen e thesarit.

VI. Per shpenzimet nga te ardhurat e trasheguara te behet korektimi perkates pas perfundimit te rakordimit perfundimtar te te ardhurave dhe shpenzimeve me Degen e Thesarit per vitin 2023.

VII. Ngarkohet nepunesi autorizues dhe Drejtoria e Ekonomike per detajimin e shpenzimeve ne periudha mujore , menjehere pasi te vihet ne dispozicion limiti I percaktuar sipas perudhave perkatese nga Ministria e Financave.

VIII. Ngarkohet nepunesi autorizues i Bashkise te kryej rishperndarje jate zbatimit te bxhetit 2024 si me poshte:

- Ndermjet projekteve te investimeve ,brenda te njejtut program,
- Ndermjet zerave te shpenzimeve korente , brenda te njejtut program,

- Rishperndarja brenda te njejtut program dhe zerit te shpenzimeve korente ndermjet njesive te ndryshme shpenzuese te cilat miratohen nga nepunesi autorizues I NJQV nga e cila varet njesia shpenzuese.

**IX.** Ngarkohet Drejtoria Ekonomike per avancim te fondeve mujore sipas realizimit te te ardhurave per vitin 2024.

**X.** Te miratoje numrin maksimal te punonjesve te bashkise, si dhe te njesive administrative e institucioneve buxhetore ne varesi te bashkise per vitin 2024 , gjithsej 386 punonjes te perhershem , nga te cilet:

- Njesia shpenzuese Bashkia Roskovec 132 punonjes te perhershem .
- Njesia shpenzuese “Ndermarja e Mirembajtjes se Mjedisit” 70 punonjes te perhershem.
- Njesia shpenzuese “Ndermarja e Sherbimeve Komunale” 32 punonjes te perhershem.
- Njesia shpenzuese “Qendra Ekonomike Arsimore” 97 punonjes te perhershem.
- Njesia shpenzuese “Ndermarrjes e Pyjeve, Ujitjes e Kullimit dhe Mirembajtje Rruge e Varreza” 51 punonjes te perhershem
- Gjendja civile 4 punonjes te perhershem.

**XI.** Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Administratat e Bashkise dhe te gjitha Njesive Shpenzuese ne varesi te bashkise .


Konceptoi: S. Çepele



Konfirmoi: D.Hoxha



Per Drejtorine Juridike dhe te Burimeve Njerezore : V. Zeqo



**KRYETAR**  
**Majlinda BUFI**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
DREJTORIA EKONOMIKE

PROJEKT - VENDIM

NR 110.DATE 14. 12.2023

“PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT TË PBA PERFUNDIMTARE 2024-2026”

Në mbështetje të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“, të ligjit nr. 9936 datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, të ligjit nr.68 datë 27.04.2017 “Për financat e qeverisjes vendore”, të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të Programimit Buxhetor Afatmesëm” të ndryshuar me udhëzimin nr.7 datë 25.02.2022 “Për një ndryshim në Udhëzimin nr.23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të Programimit Buxhetor Afatmesëm”; të Udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 6, datë 28.02.2023 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026”, si dhe materjaleve të sjella nga Drejtoria e Ekonomike;

**Ju paraqesim për diskutim e miratim,**

1. Të miratojë dokumentin për Programin Buxhetor Afatmesëm 2024-2026 perfundimtar për Bashkinë Roskovec dhe njesitë shpenzuese në vartësi, sipas tabelave në formatet output bashkelidhur:
  - Tabelen 1 “Tavanet e Programeve Buxhetore”;
  - Tabelen 2 “Burimet Buxhetore”;
  - Tabelen 3-5 “Shpenzimet sipas kategorive ekonomike”;
  - Tabelen 4 “Shpenzimet sipas klasifikimit funksional”;
  - Tabelen 4.1 “Shpenzimet sipas programeve”;
  - Tabelen 6 “Deklarata e politikës së programeve”;
  - Tabelen 7 “Shpenzime të produkteve të programeve”;
  - Tabelen 8 “Projektet e Investimeve”;
  - Tabelen 9 “Të dhënat baze mbi programet”;

- Relacion shpjegues për procesin e përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm (Shtojca 2, Programi Buxhetor Afatmesëm Vendor 2024-2026).

2. Ngarkohen ekzekutivi i bashkisë për zbatimin e këtij vendimi .


Konceptoi: S. Çepele

Miratoi: D.Hoxha

Per Drejtorine Juridike dhe te Burimeve Njerezore : V. Zeqo

**KRYETAR**

**Majlinda BUFI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
DREJTORIA EKONOMIKE

Mr. Boshq Pref  
D. 14. 12. 2023

PROJEKT - VENDIM

NR 114, DATË 14. 12. 2023

"PER

MIRATIMIN E KALENDARIT TE MENAXHIMIT TE BUXHETORE PER VITIN 2024"

Ne mbeshetje te ligjit 68/2017 "Per financat e veteqeverisjen vendore", si dhe materijaleve te paraqitura nga Drejtoria Ekonomike e Bashkise,  
Keshilli i Bashkise;

-Ju paragesim per diskutim e miratim,

1. Të miratojë kalendarin e programit buxhetor afatmesem dhe i buxheit vjetor per vitin 2024 si me poshte vijon:

PERIUDHA	DATA	INSTITUCIONI/PERSONI PËRGJEGJËS	VEPRIMI PERKATES
Dhjetor	Brenda muajt dhjetor	Kryetari i NJQV-së	Përgatit dhe paraget në Këshillin Bashkiak Kalendarin e programit buxhetor afatmesëm
Dhjetor	Deri - 31 Dhjetor	Këshilli i Njësisë Vendore	Shqyrton dhe miraton Kalendarin e programit buxhetor afatmesëm
Janar	15	Kryetari i NJQV-së	Kryetari shpërndan kalendarin e programit buxhetor afatmesëm tek të gjitha njësitë shpenzuese



Janar	31	Kryetari i NJQV-së	Kryetari i njësise paraqet për shqyrtim dhe miratim raportin e vlersimit të të ardhurave dhe shpenzimeve
Mars	1	Këshilli i Njësise Vendore	Miraton raportin e vlersimit të të ardhurave dhe shpenzimeve
Mars	Brenda dates 15	Kryetari i NJQV-së	Paraqet për miratim në Këshillin e NJQV-së tavanet përgatitore të shpenzimeve të PBA
Mars	15	Këshilli i Njësise Vendore	Miraton tavanet përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm
Mars	20	Kryetari i NJQV-së	Miraton udhëzimin e përgatitjes së buxhetit të njësise vendore dhe e shpërndan tek njësire shpenzuese
Mars - Prill	21 Mars-25 Prill	Njësire shpenzuese të bashkisë	Përgatisin kërkesat e tyre buxhetore
Mars - Prill	26 Prill - 27 Prill	Njësia e vetëqeverisjes vendore	Zhvillojnë takime konsultative me shoqëritë civile dhe grupet e interesit për PBA 2025-2027
Mars - Prill	28 Prill - 30 Prill	Njësité shpenzuese të Bashkisë	Njësité shpenzuese paraqesin në bashki kërkesat e përgatitura
Maj	1 Maj - 15 Maj	Njësia përgjegjëse për buxhetin në bashki	Kryejnë analizat e kërkesave buxhetore
Maj	16 Maj - 26 Maj	Kryetari i NJQV-së	Organizon seancat dëgjimore me Banorët
Maj	25 Maj - 27 Maj	Kryetari i NJQV-së	Prezanton dokumentin e PBA 2025-2027 me shoqëritë civile
Maj	30 Maj - 31 Maj	Njësia përgjegjëse për buxhetin në bashki	Perpilon draftin e fazes së parë të PBA-së 2025-2027
Qershor	1	Kryetari i NJQV-së	Dërgon pranë Ministrisë së Financave projekttdokumentin e programit buxhetor afatmesëm
Qershor	Deri - 20	Ministria e Financave	Dwrgon komente një raport me mendime mbi projekttdokumentin e programit buxhetor afatmesëm
Qershor	Deri -25	Njësia përgjegjëse për buxhetin në bashki	Reflektion komentet e Ministrisë së Financave
Qershor	Deri - 30	Këshilli i Njësise Vendore	Shqyrtton dhe miraton projektin e parë të programit buxhetor afatmesëm
Korrik	Deri - 5 Korrik	Kryetari i NJQV-së	Merr masat për publikimin e projektit të parë të programit buxhetor afatmesëm
Korrik	Deri - 20 Korrik	Këshilli i Njësise Vendore	Miraton tavanet përfundimtare të programit buxhetor afatmesëm
Korrik	25	Kryetari i NJQV-së	Miraton udhëzimin plotësues të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm dhe shpërndan tek njësité shpenzuese
Korrik - Gusht	26 Korrik-31 Gusht	Njësité shpenzuese të bashkisë	Përgatisin kërkesat buxhetore të rishikuara, në përputhje me tavanet përfundimtare.
Shator	1	Njësité shpenzuese të bashkisë	Njësité shpenzuese paraqesin në bashki kërkesat buxhetoretë rishikuara

Shtator	2 Shtator - 14 Shtator	Njësia përgjegjëse për buxhejin në bashki	Kryejinë analizat e kërkesave të rishikuara buxhetore
Shtator	Deri - 15	Kryetari i NJQV-së	Dërgon në Ministrinë e Financave dokumentin e programit buxhetor afatmesëm të rishikuar
Shtator-Tetor	Deri 5 Tetor	Ministria e Financave	Organizohen seanca konsultimi me njwsiw e vetwgeverijes vendore
Tetor	Deri - 20 Tetor	Ministria e Financave	Sipas rasti, Ministria e Financave dërgon mendimet përfundimtare për t' u reflektuar në dokumentin final të PBA
Tetor-Nentor	6 Tetor -30 Nentor	Njësia përgjegjëse për buxhejin në bashki	Përgatit Projektbuxhejin e vitit 2025 si dhe, dokumentin e rishikuar të PBA 2025-2027 dhe i paraget për shqyrtim ne Këshill.
Dhjetor	25	Këshilli i njësisë vendore	Miraton programin buxhetor afatmesëm përfundimtar dhe buxhetin vjetor
Dhjetor	31	Kryetari i NJQV-së	Merr masat për publikimin dokumentin e plotë të programit buxhetor afatmesëm

2.Ngarkohet nepunesi autorizues dhe GMS , EMP dhe Drejtoria Ekonomike per zbatimin e ketij kalendar.

Konceptoi : *S.Cepele*

Konfirmoi: *D.Hoxha*

Per Drejtorine Juridike dhe te Burimeve Njerezore : *V. Zeqo*





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
KOMISIONI I SHPRONËSIMIT

Nr. 8034 prot.

Roskovec, më 14.12.2023

**PROJEKT- VENDIM**

Nr. 112, datë 14.12.2023

**PËR**

**SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI “REHABILITIMI URBAN I NJË PJESE TË BLOKUT NR. 3 (FAZA 1)**

Në mbështetje të nenit 9 pika 1.2 shkronja “b” të Ligjit 139/2015 datë 19.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar; të nenit 7, nenit 8 shkronja “ç”, nenit 9 pika 1, nenit 10 pika 1 shkronja “c”, nenit 11, nenit 17 dhe nenit 19 të Ligjit Nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, i ndryshuar; VKM-së Nr. 138, datë 23.03.2000 “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, i ndryshuar; VKM-së Nr.89, datë 3.2.2016 “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë; VKB Nr. 91, datë 31.10.2023 “Për miratimin e projektit “Rehabilitimi urban i një pjese të bllokut nr.3 , në qendër të Qytetit Roskovec (Faza 1)”; VKB-së Nr. 89, datë 31.10.2023 “Për miratimin në parim dhe autorizimin e Kryetarit të Bashkisë Roskovec për lidhjen e marrëveshjes së bashkëpunimit me Federatën Shqiptare të Futbollit (FSHF)”: Marrëveshjes së bashkëpunimit lidhur ndërmjet Bashkisë Roskovec dhe Federatës Shqiptare të Futbollit (FSHF) protokolluar në institucionin tone me Nr. 7210, datë 14.11.2023 dhe pranë FSHF me Nr. 2838, datë 23.11.2023, si dhe shkresës kthim përgjigje të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Nr. 6321/1, datë 13.12.2023,

**JU PARAQESIM PËR DISKUTIM E MIRATIM:**

1. Shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zbatimi i projektit “Rehabilitimi urban i një pjese të bllokut nr.3, në qendër të Qytetit Roskovec (Faza 1)”, sipas listës bashkëlidhur.
2. Miratimin e vlerës së shpronësimit të pasurive të pasurive të sipërcituara me vlerë paraprake si më poshtë:
  - Vlera e tokës truall: 8 237 450 lekë
  - Vlera e tokës arë: 1 193 553 lekë
  - Vlera totale e shpronësimit: 9 431 003 lekë

3. Fondi për këtë qëllim do të përballohet nga fondi i caktuar nën zërin “Shpronësime për interes publik” i planifikuar në buxhetin e bashkisë.
4. Në rast miratimi të këtij projektvendimi, për zbatimin e tij ngarkohet Komisioni i Shpronësimit.

**Komisioni i Shpronësimit:**

1. Maksim Goga
2. Eneida Hoxha
3. Arben Dukaj
4. Vjollca Zeqo
5. Selman Cepele

**KRYETARI**

**Majlinda Bufi**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

PROJEKT-VENDIM

NR. 113. DATE 14.12.2023

*“PËR PERDITESIM NË LISTËN E INVENTARIT, MIRATUAR ME VKM-NË NR.108, DATË 17.02.2010 “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE QË TRASFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS KURJAN, BASHKIA ROSKOVEC”*

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 54, shkronja k); Ligjit Nr.8743, datë 31.07.2000 për “Pronat e paluajtshme të shtetit” (i ndryshuar); Ligjit Nr. 8744, datë 22.02.2001 për “Transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 500, datë 14.08.2001 për “Inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin në njësitë e qeverisjes vendore” (i ndryshuar), Udhëzimit të Ministrit të Pushtetit Vendor nr. 3, datë 18.07.2002 për “Inventarizimin e pronave të paluajtshme të shtetit nga njësitë e qeverisjes vendore”,

**Ju paraqesim për diskutim e miratim**

Përditësimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore që ndodhen në territorin e Njësisë Administrative Kurjan, Bashkia Roskovec miratuar me VKM-në nr.108, datë 17.02.2010 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Kurjan, Qarku Fier”, ketij inventari do ti shtohet pronat e lloji godina (magazine) ndodhur në pasurinë me nr.213/1 zk 3805 fshati Vlosh , Njësia Administrative Kurjan.

Pas miratimit të këtij projekt-vendimi në Këshillin e Bashkisë, ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, për zbatimin e tij.

Bashkëlidhur këtij projektvendimi do të gjeni

- Planvendosje per pronen
- Formulari për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore

Konceptoi : E.Kocaqi

Miratoi : E.Hoxha



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC

8244  
Nr. \_\_\_prot

Roskovec 21 . 12 .2023

PROJEKT-VENDIM

NR. 114. DATË 21 . 12 .2023

PËR  
MIRATIMIN E PËRFUNDIMIT TË LIKUIDIMIT DHE ÇREGJISTRIMIN E  
SHOQËRISË

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjes Vendore” i ndryshuar, neni 64, germa c; të Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, nenet 190 deri 203; VKM-së nr. 302, datë 11.05.2022, “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, VKM-së Nr. 63, datë 27.1.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”,

**Ju paraqesim për diskutim e miratim,**

1. Bilancin e gjendjes në çastin e hapjes së likuidimit në datë 12.04.2023 si dhe pasqyrave financiare për periudhën 1 Janar 2023 deri 12 .04. 2023 si dhe rezultatit financiar prej 0 (zero) lekë për këtë periudhë.
2. Bilancin të gjendjes në çastin e mbylljes së likuidimit në datë 12.12.2023 si dhe pasqyrave financiare për periudhën 12 Prill 2023 deri 30 Nentor 2023, si dhe rezultatit financiar prej 0 (zero) lekë për këtë periudhë.
3. Raportin përfundimtar të likuidimit të datës 12.12.2023, hartuar nga likuiduesi i shoqërisë Z. Edlira Toro.
4. Mbylljen e procesit së likuidimit, prishjen e shoqërisë dhe çregjistrimin e Shoqërisë Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Roskovec Sh.A. nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit.
5. Ngarkohet likuidatori me zbatimin e këtij vendimi.

**Likuiduesi: Edlira Toro**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
DREJTORIA EKONOMIKE

PROJEKT-VENDIM

NR. 115, DATË 21.12.2023

PËR

“PËR MIRATIM FONDESH SHITESE NË BUXHETIN E BASHKISË ROSKOVEC PËR VITIN 2023”

Në mbështetje të ligjit 139/2015 “Per vetëqeverisjen vendore“, neni 54 pika dh , te ligjit 68/2017 “Per financat e vetëqeverisjen vendore“neni 46 , të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor ne RSH” i ndryshuar neni 47 , të udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomis nr.9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, Aktin Normativ nr. 6 date 14.12.2023 “Per disa ndryshime dhe shtesa ne ligjin nr.84/2022 “Per buxhetin e vitit 2023” ,te shkreses se MFE nr.19973/1 prot. ,date 16.11.2023, si dhe materialeve te sjelle nga Drejtoria Ekonomike;

-Ju paraqesim për diskutim e miratim,

- I. Të miratohet fondi shtese i akorduar per bashkine Roskovec prej **16,100,000** leke si transfert e pakushtezuar e pergjithshme për shlyerje detyrimesh te prabambetura sipas percaktimeve ne aktin normative te mesiperm.
- II. Të miratohet fondi shtese i akorduar nga Ministria e Finances me vlere prej **4,955,419** leke per pagesen e TVSH per projektin me financim te huaj “Rivitalizimi I shkolles Qender Komunitare Kurjan”
- III. Ngarkohet Administratat e Bashkise per zbatimin e ketij vendimi.

Konceptoi : S.Cepele

Konfirmoi: D.Hoxha

Per Drejtorine Juridike dhe te Burimeve Njerezore : V. Zeqo

